

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2025

Shtojca 15.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

Datë: 21.10.2025

Drejtuar: Operatorit ekonomik RAFIN COMPANY sh.p.k me NIPT L52125110A dhe me adresë Tiranë, Rruga "Haxhi Kika", Njesia Administrative Nr.5, Nr. Pasurie 6/538 H 1, Ap 4.

Operatorit Ekonomik (OE) ☒ **X** **ose**

[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒ **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ **X** **JO** ☐

- Operatori ekonomik mbështetës **I 2A Sh.p.k** me **NIPT M11630006B**, me adresë Tiranë, Bërxull Bërxull Zona Kadastrale, Nr. 1167.

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Kontratë shërbimi

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 mujor.

Numri i Procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF: 58380-08-18-2025

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV: 98341110-9 - Shërbime mirëmbajtjeje

Fondi limit: 54 161 860.31 (pesëdhjetë e katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë pikë tridhjetë e një) **Lekë pa Tvsh.**

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare Euro kursit të Bankës së Shqipërisë është **552 360.2** (peseqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë pikë dy) **Euro pa Tvsh.** (Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 21.05.2025 është 98.05 lekë).

7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 (dymbëdhjetë) muaj (Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas kërkesës, në bazë të marrëveshjes kuadër).

8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 03.09.2025 Ora: 09:00

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Datë 07.10.2025

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: Buletini Nr.58 datë 13.10.2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomike **CAUSHI M sh.p.k** me **NIPT L88419801O & K.M.K sh.p.k** me **NIPT L78223801E & ERAL CONSTRUCTION COMPANY sh.p.k** me **NIPT K82230002K** me ofertë ekonomike **49 290 700** (dyzet e nëntë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind) **Lekë pa Tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Operatori ekonomik **G.D.A. sh.p.k** me **NIPT M42008005I** me ofertë ekonomike **52 758 970** (pesëdhjetë e dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) **Lekë pa Tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Operatori ekonomik **EA ENGINEERING sh.p.k** me **NIPT L97522901O** me ofertë ekonomike **52 362 200** (pesëdhjetë e dy milion e treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind) **Lekë pa Tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. Operatori ekonomik **RAFIN COMPANY sh.p.k** me **NIPT L52125110A** me ofertë ekonomike **42 777 290** (dyzetë e dy milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) **Leke pa Tvsh.**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☒ JO ☐

- Operatori ekonomik mbështetës **I 2A Sh.p.k** me **NIPT M11630006B**, me adresë Tiranë, Bërxull Bërxull Zona Kadastrale, Nr. 1167.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomike **CAUSHI M sh.p.k** me **NIPT L88419801O** & **K.M.K sh.p.k** me **NIPT L78223801E** & **ERAL CONSTRUCTION COMPANY sh.p.k** me **NIPT K82230002K** me ofertë ekonomike **49 290 700** (dyzet e nëntë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind) **Lekë pa Tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Gjatë shqyrtimit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomike **CAUSHI M sh.p.k** me **NIPT L88419801O** & **K.M.K sh.p.k** me **NIPT L78223801E** & **ERAL CONSTRUCTION COMPANY sh.p.k** me **NIPT K82230002K**, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave konstatoi se kriteret e veçanta dhe të përgjithshme sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) të cilat nuk i plotëson janë si më poshtë;

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë **Caushi M Sh.p.k & K.M.K Sh.p.k & Eral Construction Company Sh.p.k**, nuk ploteson piken 2.3.5 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, pasi sipas Akt-Marrëveshjes së Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve Ekonomikë të datës **03.09.2025**, ku është percaktuar se operatori ekonomik "**Caushi M**" Sh.p.k zotëron një pjesëmarrje prej **30.83%** në këtë bashkim, dhe në përputhje me këtë përqindje, ka marrë përsipër të kryejë **30.83% të të gjithë zërave të punimeve** të kontratës. Sipas pikës 2.3.5 të kriterëve të kualifikimit të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik një numër të caktuar punonjësish të pajisur me **diploma/çertifikata të arsimit profesional**, të lëshuara nga institucione të licencuara ose të akredituara sipas **Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”**, si dhe të rezultojnë në **listëpagesën e muajit të fundit dhe në vazhdim**. Numri minimal i kërkuar për punonjës bojaxhi është **18 punonjës**. Në përputhje me pjesëmarrjen prej **30.83%**, operatori ekonomik “Caushi M” Sh.p.k duhet të plotësonte kriterin në mënyrë proporcionale, duke disponuar minimumi **6 punonjës bojaxhi** të kualifikuar dhe aktivë në listëpagesë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik, konkretisht **listëpagesat, kontratat individuale të punës dhe dokumentacioni i kualifikimit profesional**, rezulton se “Caushi M” Sh.p.k **ka në dispozicion vetëm 5 punonjës bojaxhi, nën minimumin e kërkuar** sipas përqindjes së zërave të marrë përsipër për realizim. Mosplotësimi i këtij kriteri përbën **shkelje të pikës 2.3.5 të kërkesave të kualifikimit dhe si i tillë, përbën shkak të ligjshëm për skualifikim**.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë **Caushi M Sh.p.k & K.M.K Sh.p.k & Eral Construction Company Sh.p.k**, nuk ploteson piken 2.3.5 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, pasi sipas Akt-Marrëveshjes për bashkim të përkohshëm të operatorëve ekonomikë, të datës **03.09.2025**, ku është percaktuar se operatori "**KMK**" Sh.p.k zotëron **31.67%** të pjesëmarrjes në bashkim dhe ka marrë përsipër të realizojë **31.67% të të gjithë zërave të punimeve** të kontratës. Në përputhje me **përqindjen e angazhimit**, operatori ekonomik **KMK Sh.p.k** duhet të përmbushë në mënyrë proporcionale edhe **kriterin e kapacitetit teknik të stafit**, të percaktuar në **pikën 2.3.5 të dokumenteve të tenderit**. Konkretisht, për kategorinë “**specialist për sisteme të thata**”, ku kërkesa minimale është **2 (dy) punonjës**, operatori duhet të sigurojë **të paktën 1 (një) specialist** të tillë, në përputhje me **31.67%** të angazhimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të vetëdeklaruar dhe i listëpagesave të muajit të fundit, rezulton se operatori **KMK Sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë punonjës të kualifikuar si specialist për sisteme të thata, pra nuk përmbush kërkesën minimale** për këtë profil teknik në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në kontratë. Ky mosplotësim përbën shkelje të **pikës 2.3.5 të dokumenteve të tenderit**, e cila kërkon që për të gjitha pozicionet e percaktuara, ofertuesi të disponojë personel të kualifikuar dhe të evidentuar në listëpagesë, me dokumentacion mbështetës për kualifikimin profesional në përputhje me **Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”**. Mosplotësimi i këtij kriteri përbën **shkelje të pikës 2.3.5 të kërkesave të kualifikimit dhe si i tillë, përbën shkak të ligjshëm për skualifikim**.

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Caushi M” Sh.p.k & “K.M.K” Sh.p.k & “Eral Construction Company” Sh.p.k, nuk ploteson pikën 2.3.5 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, pasi sipas Akt-Marrëveshjes për bashkim të përkohshëm të operatorëve ekonomikë, datë 03.09.2025, ku është përcaktuar se operatori “Eral Construction Company” Sh.p.k zotëron një pjesëmarrje prej 37.5% në bashkimin e përkohshëm dhe ka marrë përsipër të realizojë 37.5% të të gjithë zërave të punimeve të kontratës. Sipas pikës 2.3.5 të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës të pajisur me **diploma apo çertifikata të arsimit profesional, të lëshuara nga institucione të akredituara/licencuara sipas Ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,** si dhe të jenë aktivë në listëpagesën e muajit të fundit dhe në vazhdim. Në përputhje me përqindjen e angazhimit të operatorit “Eral Construction Company” Sh.p.k në bashkim, ky subjekt duhet të përmbushë proporcionalisht kërkesën për numrin minimal të punonjësve për çdo kategori profesionale. Në mënyrë të veçantë, për kategoritë:
 - Bojaxhi (18 të kërkuar në total) → 37.5% e tyre = 7 punonjës
 - Suvatues (4 të kërkuar në total) → 37.5% e tyre = 2 punonjës

Nga kontrolli i dokumentacionit të vetëdeklaruar dhe verifikimi i listëpagesave, kontratave individuale të punës dhe çertifikatave profesionale, rezulton se operatori “Eral Construction Company” Sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë punonjës të kualifikuar dhe të siguruar për pozicionet bojaxhi dhe suvatues, duke mos përmbushur kështu as minimumin proporcional të kërkuar për këto dy profile të domosdoshme për realizimin e objektit të kontratës. Për rrjedhojë, operatori **nuk përmbush kërkesën minimale të përcaktuar në pikën 2.3.5, çka përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e bashkimit të operatorëve “Caushi M” Sh.p.k, “K.M.K” Sh.p.k dhe “Eral Construction Company” Sh.p.k, për mosplotësim të kapacitetit teknik në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes të secilit operator në bashkim.**

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë Caushi M Sh.p.k & K.M.K Sh.p.k & Eral Construction Company Sh.p.k, nuk ploteson pikën 2.3.7 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, pasi sipas këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar **të paktën 8 (tetë) punonjës,** të pajisur me **çertifikatën e trajnimit “Për punimet në lartësi/montim skelerie”** ose ekuivalente, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Nga shqyrtimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10, dhe dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Caushi M” Sh.p.k, “K.M.K” Sh.p.k dhe “Eral Construction Company” Sh.p.k, rezulton se **asnjë prej operatorëve në bashkim nuk ka deklaruar punonjës të pajisur me çertifikata për punime në lartësi/montim skelerie, siç kërkohet në pikën 2.3.7.** Operatorët ekonomik pjesëmarrës në BOE kanë deklaruar që kanë punonjës të pajisur me Çertifikatë për punimet në lartësi por nuk kanë deklaruar Titullin e kualifikimit, Nr. e amzes si dhe institucionin që e ka lëshuar këtë certifikim sipas kërkesës në Dokumentat Standarte të Tenderit. Në mungesë të këtij stafi teknik të certifikuar dhe të dokumentuar, **nuk është përmbushur kërkesa minimale** lidhur me sigurinë në punë, e cila është një **kriter i detyrueshëm kualifikimi** në kuadër të standardeve ligjore dhe teknike të aplikueshme për këtë kontratë. Për rrjedhojë, **bashkimi i operatorëve ekonomikë “Caushi M” Sh.p.k, “K.M.K” Sh.p.k dhe “Eral Construction Company” Sh.p.k nuk përmbush kriterin e kapacitetit teknik të parashikuar në pikën 2.3.7 të dokumenteve të tenderit.**

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë **Caushi M Sh.p.k & K.M.K Sh.p.k & Eral Construction Company Sh.p.k**, nuk ploteson piken 2.3.9 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, pasi sipas pikës 2.3.9 të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Deklaratë/Certifikatë Konformiteti CE, ose Ecolabel, ose raporte testimi të lëshuara nga ente certifikues të akredituar**, për materialet që do të përdoren në realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes të parashikuara në preventivin përkatës. Këto dokumente duhet të vërtetojnë që materialet përmbushin **standarde teknike kombëtare apo ndërkombëtare të miratuara**, të specifikuara në Shtojcën 6 – **Formulari i Specifikimeve Teknike**, i publikuar në SPE (Sistemi i Prokurimeve Elektronike). Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve “**Caushi M**” Sh.p.k, “**K.M.K**” Sh.p.k dhe “**Eral Construction Company**” Sh.p.k, rezulton se **nuk janë dorëzuar as deklarata, certifikata konformiteti, Ecolabel apo raporte testimi për materialet e parashikuara**, sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja e këtyre dokumenteve përbën **mosplotësim të drejtpërdrejtë të pikës 2.3.9**, e cila ka për qëllim **garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë teknike të materialeve** që do të përdoren gjatë ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave ligjore dhe standardeve të aplikueshme. Pra bashkimi i operatorëve ekonomike “**Caushi M**” Sh.p.k, “**K.M.K**” Sh.p.k dhe “**Eral Construction Company**” Sh.p.k nuk përmbush kriterin minimal të përcaktuar në pikën 2.3.9 dhe, si i tillë, skualifikohet nga procedura e prokurimit për **mosplotësim të standardeve teknike të kërkuara për materialet**.

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë **Caushi M Sh.p.k & K.M.K Sh.p.k & Eral Construction Company Sh.p.k**, nuk ploteson piken 2.3.11 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, pasi sipas pikës 2.3.11 të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues duhet të jetë **i pajisur me licencën profesionale përkatëse**, të lëshuar nga **Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL)**, me Kod III.2.B “**Grumbullim, Transportim, Ruajtje, i Mbetjeve Urbane**”, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.9010, datë 13.02.2003 “**Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta**”, i ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “**Caushi M**” Sh.p.k, rezulton se subjekti **nuk është i pajisur me licencën përkatëse** sipas kërkesave të pikës 2.3.11. Në vend të saj, subjekti ka paraqitur një **Akt-Marrëveshje Nr.4109 Rep., Nr.1086 Kol., me subjektin “PE-VLA-KU” Sh.p.k**, me anë të së cilës synon të mbulojë këtë kërkesë përmes bashkëpunimit me një palë të tretë. Megjithatë, **kërkesa në pikën 2.3.11 është e drejtpërdrejtë dhe e qartë**, duke specifikuar se **operatori ekonomik ofertues vetë duhet të zotërojë licencën për grumbullimin, transportimin dhe ruajtjen e mbetjeve urbane**, dhe jo përmes kontratash ose marrëveshjesh me operatorë të tjerë. Gjithashtu, në bazë të Akt-Marrëveshjes për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë, të datës 03.09.2025, është përcaktuar se operatori “**Caushi M**” Sh.p.k zotëron **30.83% të pjesëmarrjes** dhe ka marrë përsipër të realizojë **30.83% të të gjithë zërave të punimeve** në kontratë, përfshirë dhe **zërat që lidhen me transportimin e mbetjeve**. Për pasojë, është **detyrim ligjor dhe kontraktor** që operatori të zotërojë personalisht **licencën përkatëse**, dhe **nuk mund të delegojë përmbushjen e këtij kriteri** përmes marrëveshjes me një subjekt tjetër që nuk është pjesë e bashkimit të përkohshëm. Në këto kushte, operatori ekonomik “**Caushi M**” Sh.p.k nuk përmbush kërkesën minimale të përcaktuar në pikën 2.3.11, dhe si rrjedhojë, bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomike “**Caushi M**” Sh.p.k,

“K.M.K” Sh.p.k dhe “Eral Construction Company” Sh.p.k skualifikohet nga procedura e prokurimit për mosplotësim të kapacitetit ligjor të kërkuar.

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë **Caushi M Sh.p.k & K.M.K Sh.p.k & Eral Construction Company Sh.p.k, nuk ploteson piken 2.3.12 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, pasi sipas pikes 2.3.12 të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton disponimin në pronësi ose me qira të mjeteve dhe pajisjeve teknike e mbrojtëse, në sasi dhe cilësi të përcaktuar në këtë pikë, të cilat janë të domosdoshme për ekzekutimin e kontratës. Këto të dhëna duhet të pasqyrohen në mënyrë të detajuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10, dhe të shoqërohen me dokumentacionin përkatës për verifikim të mëtjetshëm në fazën pas kualifikimit. Pas analizimit të dokumentacionit të vetëdeklaruar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Caushi M” Sh.p.k, “K.M.K” Sh.p.k dhe “Eral Construction Company” Sh.p.k, u konstatua se nuk është përmbushur plotësisht kërkesa minimale për pajisjen me “Skeleri metalike” në sasinë prej 3000 m² dhe “Jelekë me shirita fosforishentë” në sasinë prej 120 copë, si më poshtë:**
- **Operatori “Caushi M” Sh.p.k ka deklaruar:**
 - **Skeleri metalike – 500 m², sipas faturave: Nr.1139, datë 17.04.2021; Nr.1347, datë 15.04.2021; dhe Nr.1082, datë 12.04.2021.**
 - **Jelekë me shirita fosforishentë – 62 copë, sipas faturave: Nr. 9033, datë 09.11.2022; dhe Nr. 3184, datë 23.10.2019.**
 - **Operatori “Eral Construction Company” Sh.p.k ka deklaruar:**
 - **Skeleri metalike, sipas Faturës së shitjes Nr. 201, datë 14.07.2023, pa specifikuar sasinë në metra katrorë.**
 - **Jelekë me shirita fosforishentë, sipas Faturës së shitjes Nr. 85, datë 28.02.2017, gjithashtu pa sasi të përcaktuar.**
 - **Operatori “K.M.K” Sh.p.k ka deklaruar:**
 - **Skeleri metalike – 500 m² në pronësi dhe 1000 m² me qira, sipas kontratës Nr. 4750 Rep., Nr. 910 Kol., datë 26.10.2023.**
 - **Jelekë me shirita fosforishentë – 50 copë.**

Nga verifikimi përmbledhës i të dhënave të mësipërme, rezulton se **në total janë deklaruar dhe dokumentuar vetëm 2000 m² skeleri metalike dhe 112 copë jelekë me shirita fosforishentë**, ndërkohë që sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit, kërkohej sasia minimale prej **3000 m² skeleri metalike dhe 120 copë jelekë**. Pra, rezulton **mungesë e dokumentuar për 1000 m² skeleri metalike dhe 7 copë jelekë me shirita fosforishentë**. Bazuar në këtë analizë, konstatohet se bashkimi i përkohshëm **nuk përmbush kriterin minimal të pikës 2.3.12**, duke mos garantuar plotësisht disponueshmërinë e pajisjeve teknike dhe mbrojtëse të nevojshme për ekzekutimin e kontratës. **Për rrjedhojë, bashkimi i operatorëve ekonomike “Caushi M” Sh.p.k dhe “K.M.K” Sh.p.k dhe “Eral Construction Company” Sh.p.k skualifikohet nga procedura e prokurimit, për mosplotësim të kërkesave teknike dhe mungesë të dokumentacionit mbështetës për mjetet e kërkuara në pikën 2.3.12 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.**

2. Operatori ekonomik **G.D.A. sh.p.k me NIPT M42008005I me ofertë ekonomike 52 758 970 (pesëdhjetë e dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) Lekë pa Tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Gjatë shqyrtimit të ofertës së operatorit ekonomik **G.D.A. sh.p.k me NIPT M42008005I**, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave konstatoi se kriteret e veçanta dhe të përgjithshme sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) të cilat nuk i plotëson janë si më poshtë;

1. Operatori ekonomik **G.D.A. sh.p.k** nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në Shtojcën 3 të DST, dokument ky i detyrueshëm për të konsideruar një ofertë të vlefshme dhe që garanton seriozitetin e ofertuesit gjatë gjithë procesit të prokurimit. Mosparaqitja e këtij dokumenti përbën shkak të drejtpërdrejtë skualifikimi.
2. Operatori ekonomik **G.D.A. sh.p.k** nuk ka paraqitur Licencën profesionale të kategorisë NS-4 B, e cila mbulon punimet e rifiniturës së muraturës dhe të lidhura me to, licencë kjo e kërkuar në mënyrë të shprehur në pikën 2.1.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Kjo licencë është e domosdoshme për realizimin e objektit të kontratës dhe mungesa e saj nënkupton pamundësinë ligjore dhe teknike për të kryer punimet e përshkruara.
3. Operatori ekonomik **G.D.A. sh.p.k** nuk ka paraqitur pasqyrat financiare vjetore të certifikuara nga organet tatimore për tre vitet e fundit (2022, 2023 dhe 2024), sipas kërkesës në pikën 2.2.1 të DST. Këto bilance janë dokumentacioni bazë që vërteton stabilitetin financiar dhe aftësinë për të përballuar realizimin e kontratës. Mungesa e tyre e pamundëson Autoritetin Kontraktor të vlerësojë qëndrueshmërinë financiare të subjektit dhe përbën gjithashtu shkak të drejtpërdrejtë për skualifikim.
4. Operatori ekonomik **G.D.A. sh.p.k** nuk ka paraqitur vërtetimin e xhiros vjetore për periudhën 2022, 2023, 2024, dokument i cili duhet të lëshohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, sipas kërkesës së pikës 2.2.2 të DST. Ky dokument duhet të dëshmojë se operatori ekonomik ka realizuar një xhiro minimale vjetore jo më të vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit në të paktën një nga vitet e kërkuara. Mungesa e këtij dokumenti nuk lejon vlerësimin e kapacitetit financiar të nevojshëm për realizimin e kontratës.
5. Operatori ekonomik **G.D.A. sh.p.k** nuk përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.3 të DST, e cila ka të bëjë me paraqitjen e dokumentacionit që vërteton punësimin mesatar të jo më pak se 120 punonjësve për periudhën Shkurt 2025–Prill 2025 dhe në vazhdim. Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar vërtetimin nga Administrata Tatimore për këtë punësim, as listëpagesat përkatëse të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Ky kriter është vendosur për të garantuar që operatori ka kapacitetin njerëzor të nevojshëm për të përballuar punimet e parashikuara në objektin e kontratës dhe për mosplotësimin e tij, operatori nuk kualifikohet.

Për të gjitha sa më sipër, rezulton se operatori ekonomik **G.D.A. sh.p.k** nuk përmbush një numër të konsiderueshëm kriteresh thelbësore të kualifikimit dhe si rrjedhojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, skualifikohet nga procedura e prokurimit. Autoriteti Kontraktor mbështet këtë vendimmarrje në mungesën e dokumentacionit të kërkuar sipas DST dhe pamundësinë për të vlerësuar kapacitetin teknik, profesional dhe financiar të operatorit për të përmbushur detyrimet që burojnë nga realizimi i kësaj kontrate.

3. Operatori ekonomik **EA ENGINEERING sh.p.k** me NIPT **L975229010** me ofertë ekonomike **52 362 200** (pesëdhjetë e dy milion e treqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind) **Lekë pa Tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Gjatë shqyrtimit të ofertës së operatorit ekonomik **EA ENGINEERING sh.p.k me NIPT L975229010**, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave konstatoi se kriteret e veçanta dhe të përgjithshme sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) të cilat nuk i plotëson janë si më poshtë;

1. Operatori ekonomik “**EA ENGINEERING**” Sh.p.k, **nuk ploteson piken 2.3.1 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit, pasi nuk është paraqitur dokumentacion i plotë për realizimin e kontratave të ngjashme në vlerën e kërkuar (minimumi 40% e fondit limit).**
2. Operatori ekonomik “**EA ENGINEERING**” Sh.p.k, **nuk ploteson piken 2.3.2 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në lidhje me plotësimin e këtij kriteri.**
3. Operatori ekonomik “**EA ENGINEERING**” Sh.p.k, **nuk ploteson piken 2.3.3 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit pasi sipas Shtojcës 10 Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit të paraqitur rezulton se nuk e përmbush numrin minimal të kërkuar të punonjësve sipas këtij kriteri.**
4. Operatori ekonomik “**EA ENGINEERING**” Sh.p.k, **nuk ploteson piken 2.3.5 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit pasi sipas Shtojcës 10 Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit të paraqitur nuk ka deklaruar punonjësit e kërkuar sipas kësaj kerkese, duke mos dokumentuar përmbushjen e kërkesës për stafin teknik të kualifikuar sipas profileve të kërkuara (bojaxhi, suvatues, teknik ndërtimi, specialist sisteme të thata, fasadierë).**
5. Operatori ekonomik “**EA ENGINEERING**” Sh.p.k, **nuk ploteson piken 2.3.7 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit pasi sipas Shtojcës 10 Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit të paraqitur nuk ka deklaruar punonjësit e kërkuar sipas kësaj kerkese, duke mos dokumentuar përmbushjen e kërkesës për stafin teknik të kualifikuar sipas profilit të kërkuar 8 punonjës të trajnuar për punime në lartësi/montim skelerie.**
6. Operatori ekonomik “**EA ENGINEERING**” Sh.p.k, **nuk ploteson piken 2.3.8 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit pasi nuk janë paraqitur katalogë ose skeda teknike të materialeve që do të përdoren, sipas kërkesave të Shtojcës 6.**
7. Operatori ekonomik “**EA ENGINEERING**” Sh.p.k, **nuk ploteson piken 2.3.9 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit pasi nuk janë paraqitur Deklaratë/Certifikatë Konformiteti CE, ose Ecolabel, ose raporte testimi të lëshuara nga ente certifikues të akredituar për materialet e specifikuar në Shtojcën 6, për të cilat kerkohen standarte teknike të miratuara.**

8. Operatori ekonomik “EA ENGINEERING” Sh.p.k, nuk ploteson piken 2.3.11 të Kapacitetit Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit pasi nuk është paraqitur licenca për “Grumbullim, Transportim, Ruajtje të Mbetjeve Urbane” (Kodi III.2.B).
9. Operatori ekonomik “EA ENGINEERING” Sh.p.k, nuk ploteson piken 2.3.12 të Kapaciteti Teknik dhe Profesional sipas kërkesave të Dokumenteve Standarde të Tenderit pasi sipas Shtojces 10 Formularit Permblledhes të Vetdeklarimit të paraqitur dokumentacioni i deklaruar për mjetet dhe pajisjet teknike/mbrojtëse është i paplotë dhe nuk mbulon minimumin e kërkuar sipas DST.

Në këto kushte, bazuar në Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", operatori ekonomik “EA ENGINEERING” Sh.p.k skualifikohet nga procedura e prokurimit, për mosplotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik RAFIN COMPANY sh.p.k me NIPT L52125110A dhe me adresë Tiranë, Rruga ”Haxhi Kika”, Njesia Administrative Nr.5, Nr. Pasurie 6/538 H 1, Ap 4., se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **42 777 290 (dyzetë e dy milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) Lekë pa Tvsh.**, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike Tiranë me adresë Rruga “5 Maji”, God.17, Tiranë, Tel.042227376, e-mail: dpn3@tirana.al, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do të anulohet, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, (të ndryshuar).

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO ☐ JO ☒

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

OLSI ISUFAJ